

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

**Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë/Mitrovica:
Risitë lidhur me status dhe shqetësimet e vazhdueshme
për të drejta të njeriut**

**SMSJ Edicioni 1
Janar 2011**

Hyrje

Për afro tashmë tri vite, sistemi gjyqësor në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica ka funksionuar vetëm me kapacitet të kufizuar.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) pas monitorimit nga afër të zhvillimeve në komunat në veri të Kosovës, që nga viti 2008 ka publikuar raporte të rregullta ku ka nënvizuar shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë rezultuar nga funksionimi i kufizuar i gjykatave në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica.¹ OSBE vazhdimisht ka theksuar ndikimin negativ të cilin gjyqësori jo-plotësisht funksional në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica ka si mbi sundimin e ligjit ashtu edhe në ushtrimin e të drejtave themelore, të tilla siç janë e drejta për liri, e drejta për qasje në drejtësi dhe e drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme.²

Përkundër përpjekjeve intensive si nga partnerë ndërkombëtar ashtu edhe ata vendor, nuk ka pasur ndonjë përparim të madh në operimin e sistemit gjyqësor dhe institucioneve përkatëse për sundim të ligjit në këtë rajon. Ky raport prezanton risitë në statusin aktual mbi funksionimin e gjyqësisë në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica dhe ri-përsërit shqetësimet lidhur me shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut dhe kushtet e vështira të punës në disa zyra gjyqësore, të cilat ndikojnë në ndarjen e duhur të drejtësisë.³

Risitë lidhur me statusin

Kompleksi i gjykatës në Mitrovica/Mitrovicë që ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica është i pa-qasshëm për gjyqtarët dhe prokurorët publik lokal dhe personelin ndihmës të tyre që pas ngjarjeve të muajve shkurt dhe mars 2008.⁴ Që nga vendosja e tyre zyrtare me 9 dhjetor 2008, ky kompleks i gjykatës është administruar nga personeli i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili aktualisht përbëhet prej gjashtë gjyqtarëve, katër prokurorëve, personelit vendor (shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës) dhe personelit ndihmës ndërkombëtar.⁵

1 Shih Raportin e OSBE-së, *Reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës në ndikojnë seriozisht në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndikojnë negativisht në gjykatat e regjioneve tjera, duke rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut* (mars 2008); raporti mund të qaset në: http://intranet/n/s/documents/monitoring/6/525_2.pdf. Raporti i OSBE-së, *Shqetësimet e Vazhdueshme për të Drejtat e Njeriut dhe Zhvillimet e Fundit* (dhjetor 2008), http://intranet/n/s/documents/monitoring/6/09080529_1240_sq.pdf. Raporti Tematik i OSBE-së, *Përdorimi i Paraburgimit në Procedurat Penale në Kosovë: Shqyrtim dhe Analizë Gjithëpërfshirëse e Brengave të Mbetura* (Pjesa I), faqe 22-23, http://intranet/n/s/documents/monitoring/4/09121115_1367_sq.pdf. Po ashtu Raporti i OSBE-së, *Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë/Mitrovica; Risitë lidhur me Status dhe Shqetësimet e Vazhdueshme për të Drejta të Njeriut* (shkurt 2010), http://intranet/n/s/documents/monitoring/6/10022243_1455_sq.pdf.

2 Nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ).

3 Ky raport përfshin periudhën shkurt 2008 deri në tetor 2010.

4 Duke filluar nga 21 shkurti 2008, një grup prej 50 deri në 200 protestues, në mes tyre edhe të punësuarit e sistemit gjyqësor të para-1999-ës, u mblodhën jashtë kompleksit të gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica në mëngjeset e ditëve të punës duke kërkuar që të hyjnë në ndërtesë dhe që ajo të i kthehet sistemit gjyqësor të Serbisë. Protestuesit hynë me forcë në ndërtesë me 14 mars 2008. Me 17 mars 2008 në një operacion të përkrahur nga KFOR-i, Policia e UNMIK-ut hyri në ndërtesë dhe arrestoi uzurpuesit. Trazira serioze civile pasuan të cilat quan në vdekjen e një polici civil ndërkombëtar.

5 Sipas Zyrtarit Ligjor të Zyrës së Kryesuesit të Drejtësisë të EULEX, ka më shumë gjykatës dhe prokurorë të EULEX në Mitrovicë/Mitrovica sesa në ndonjë rajon tjetër.

Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vendor të cilët më parë punonin në kompleksin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica vazhdojnë punën me kapacitet të kufizuar në objektin e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn.

Niveli i gjykatës së qarkut

Gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, e rivendosur në objektin e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn, mban seanca në raste penale që përfshijnë caktimin, vazhdimin dhe/ose përfundimin e masave të parapara për të siguruar praninë e të pandehurve, parandalimin e përsëritjes së veprës dhe për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurave penale. Kjo gjykatë po ashtu zhvillon seanca për konfirmim të aktakuzës në rastet kur disa nga masat më të rrepta nga ato të lartpërmendurat vendosen kundër të pandehurve. Si gjykatë e shkallës së dytë për çështje penale, gjykata e qarkut kohëve të fundit ka filluar t'i trajtojë disa raste ku afati i parashkrimit ligjor do të skadojë së shpejti, apo veçse ka skaduar.⁶

Si gjykatë e shkallës së parë për çështje civile, gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica shqyrton rastet e shkurorëzimeve dhe procedon kërkesat për njohjen e aktgjykimeve të huaja. Prej janarit deri në shtator 2010, kjo gjykatë ka njohur 286 aktgjykime të huaja. Si gjykatë e shkallës së dytë për çështje civile, gjykata trajton ankesat që përfshijnë masa të përkohshme, dhunë familjare, pengim-posedim të pronës dhe lëndët e punës.⁷ Gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica trajton ankesat nga gjykatat komunale të Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn; këto gjykata komunale janë të ndikuara nga funksionimi i kufizuar i sistemit gjyqësor, d.m.th. nga pengesat në procedimin e rasteve me ankesë.

Niveli i gjykatës komunale

Gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica (e cila mbulon Mitrovicë/Mitrovica e veriut dhe të jugut, si dhe Zvečan/Zveçan) gjithashtu operon në kapacitet të kufizuar nga objekti i gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn. Kjo gjykatë mban seanca në raste penale që përfshijnë caktimin, vazhdimin dhe/ose përfundimin e masave të parapara për të siguruar praninë e të pandehurve, parandalimin e përsëritjes së veprës dhe për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurave penale. Gjykata po ashtu zhvillon seanca për konfirmim të aktakuzës dhe gjykime në raste penale ku përsihen të miturit. Po ashtu ka mbajtur gjykime në një numër të kufizuar të lëndëve tjera penale.

Në rastet civile, gjykata mban gjykime vetëm në të ashtuquajturat raste emergjente ku përfshihen rastet e pengim-posedimit, rastet e dhunës familjare, rastet lidhur me plotësimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë mbi kujdesin e fëmijës, dhe rastet e trashëgimisë.⁸

Nga shkurti 2008 deri në tetor 2010, gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica ka mbajtur dhe përfunduar gjykimet në 46 raste penale⁹ (dy nga të cilat ishin kryer nga gjyqtarët e EULEX-

⁶ Gjykata ka filluar t'i shqyrtojë afro dyzet lëndë me ankesë nga gjykata komunale e Vushtrri/Vučitrn, sipas numrit rendor. Veç kësaj, gjykata ka trajtuar edhe disa lëndë me ankesë nga gjykata komunale e Skenderaj/Srbica, pas parashtrësive të palëve të interesuara.

⁷ Kjo nuk bëhet rregullisht; zakonisht, palët e interesuara parashetrojnë propozim pranë gjykatës dhe kolegji i gjyqtarëve do të merr aktvendime nëse është apo nuk është i bazuar.

⁸ Që nga 1 janari deri në përfundim të shtatorit 2010, gjykata komunale në Mitrovicë/Mitrovica ka pranuar katër raste pronësore lidhur me pengim-posedim dhe gjashtë raste të punës.

⁹ Nga shkurti 2008 deri në shkurt 2010, gjykata komunale në Mitrovicë/Mitrovica ka zhvilluar dhe përfunduar gjykimet në 17 raste penale dhe ka trajtuar 18 raste civile.

it) dhe 484 lëndë civile.¹⁰ Gjykata ende ofron shërbime minimale për legalizime që përfshijnë kontrata dhe ndryshime në kontrata dhe lëshon autorizime dhe vërtetime për hetime penale.

Gjykata për kundërvajtje e Mitrovicë/Mitrovica ende funksionon me kapacitet të kufizuar në objektin e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn. Ndërmjet fundit të shkurtit 2008 dhe fundit të tetorit 2010, kjo gjykatë ka pranuar 31,715 raste, përfshirë raste nga veriu i Mitrovica/Mitrovicë dhe Zvečan/Zveçan.¹¹ Barra me lëndë po rritet. Si krahasim që nga fundi i shkurtit 2008 deri nga fundi i dhjetorit 2008, kjo gjykatë ka pranuar 8,400 raste që vijnë nga pjesa jugore e komunës së Mitrovicë/Mitrovica (gjykata nuk ka pranuar asnjë rast nga pjesa veriore) përderisa që nga janari 2009 deri në nëntor 2009, kjo gjykatë ka pranuar më se 9,700 raste, përfshirë ato nga Mitrovicë/Mitrovica veriore dhe Zvečan/Zveçan.

Gjykatat komunale dhe për kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq ende mbesin jo-funksionale që prej shkurtit 2008. Rastet penale për të cilat kërkohet caktimi, vazhdimi dhe/ose përfundimi i masave të parapara për të siguruar praninë e të pandehurve, parandalimin e përsëritjes së veprës dhe për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurave penale, trajtohen përmes transferimit në ndonjë gjykatë tjetër komunale në rajon.

Gjykatat komunale dhe për kundërvajtje në Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn nga fundi i tetorit 2010, janë ende gjykatat e vetme në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica që operojnë pak a shumë normalisht.

Prokuroria publike në nivelin e qarkut dhe atë komunal

Zyrat e prokurorisë së qarkut dhe komunale të Mitrovicë/Mitrovica, që mbulojnë gjithë gjashtë komunat në rajon, ende operojnë nga objekti i gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn, duke ushtruar funksione të kufizuara prokuroriale. Prokuroria publike e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica kryen të gjitha detyrat deri në, dhe përfshirë edhe ngritjen e aktakuzës dhe pjesëmarrjen në seancat për konfirmim të aktakuzës pranë gjykatës së qarkut. Prokuroria publike komunale në Mitrovicë/Mitrovica kryen të gjitha detyrat deri në, dhe përfshirë edhe ngritjen e aktakuzës dhe pjesëmarrjen në seancat për konfirmim të aktakuzës në rastet brenda kompetencës së gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica. Prokurorët po ashtu marrin pjesë në disa seanca të gjykimeve.

Prokurorët gjithashtu përfaqësojnë rastet e prokurorisë që bien nën kompetencë të gjykatave komunale në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok; kurdo që është e nevojshme, pranë kryetarit të gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica parashtrohet kërkesa për bartje të kompetencës në ndonjë tjetër gjykatë që ka juridiksion të njëjtë lëndor në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica. Prokurorët komunal vazhdojnë të kryejnë tërë spektrin e detyrave prokuroriale në rastet që bien nën kompetencë të gjykatave komunale në the Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica.

¹⁰ Saktësisht, 432 raste të trashëgimisë, 35 raste të dhunës familjare, katër raste të pengim-posedimit, dy konteste të punës dhe 11 raste të alimentacionit.

¹¹ Për shkak të kushteve aktuale të vështira të punës, gjykata pranon dhe regjistron të gjitha rastet që parashtrohen. Megjithatë, trajton vetëm ato me procedurë të shkurtër dhe rastet urgjente siç janë rastet e rënda të pengimit të qetësisë dhe rendit publik, aksidentet e komunikacionit, konfiskimin e dokumenteve nga policia kur palët janë shtetas të huaj, rastet që përfshijnë persona të mitur dhe ato që duhet të barten tek gjykatat tjera të Kosovës.

Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it

Vendosja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, ka sjell përmirësime të kufizuara në funksionimin e gjyqësorit në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica deri më tani, pasi që kapacitetet e kufizuara të EULEX-it lejojnë që rastet më serioze nga Mitrovicë/Mitrovica të ndiqen dhe gjykohen në mënyrë efektive. Deri nga fundi i tetorit 2010, gjyqtarët e EULEX-it të vendosur në gjykatën e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica kanë përfunduar 40 raste penale. Njëzet e katër nga këto raste kanë përfunduar me aktgjykim dhe 16 procedurat penale janë ndërprerë për shkaqe tjera. Dy nga këto dyzet raste ishin nën juridiksion të gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica.

EULEX-i akoma mban seanca të veçanta për të marr përsipër rastet nga gjyqësori vendor. Që nga vendosja e vet në vitin 2008 deri nga fundi i tetorit 2010, EULEX-i ka marrë përsipër një numër të përgjithshëm prej 37 rasteve nga gjyqtarët vendor. Vlen të përmendet se në seanca të tilla, në të cilat marrin pjesë kryetari i gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica së bashku me gjyqtarë dhe prokurorë tjerë vendor, mbahen në objektin e kompleksit të gjykatës në veri të Mitrovica/Mitrovicë. Siguria në seanca të tilla ofrohet nga EULEX-i. Deri me tani seancat janë zhvilluar pa incidente.

EULEX-i po ashtu ka marr hapa për të përgatitur procedimin e të gjitha rasteve tjera që janë në pritje. Me atë qëllim, në mes të korrikut 2009 EULEX-i, me ndihmë të stafit vendor nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, filloi evidentimin e shkresave të lëndëve civile dhe penale që ndodheshin në objektin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica. Numri i përgjithshëm i shkresave të lëndëve civile dhe penale që janë gjetur dhe organizuar nga ekipi i evidentimit sillet përafërsisht në 3.500.¹² Ka afërsisht rreth 5,200 shkresa të lëndëve në prokuroritë publike të qarkut. Numri i përgjithshëm i shkresave të lëndëve civile dhe penale që janë gjetur dhe organizuar nga ekipi i evidentimit për gjykatat komunale të Mitrovicë/Mitrovica është afërsisht 4,600, me 3,893 lëndë tjera aktive edhe 21,711 lëndë të arkivuara në zyrat e prokurorisë publike komunale.¹³

Prej të gjitha shkresave të lëndëve penale të evidentuara dhe të arkivuara në objektin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica, afërsisht rreth 50 ishin identifikuar nga EULEX-i si raste me prioritet. Shumica nga këto 50 raste përfshijnë të pandehur që janë duke u mbajtur në paraburgim. Këto raste të cilat ndodhen në faza të ndryshme procedurale, u është dhënë prioritet mbi të gjitha rastet tjera dhe ishin të parat që janë trajtuar nga gjyqtarët e EULEX-it.

Fillimisht, ishte paraparë se në ndonjë fazë të mëvonshme, rastet do të trajtoheshin nga grupe të përziera të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të përbërë prej pesë gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë të Kosovës, pesë gjyqtarë dhe prokurorë serb të Kosovës dhe pesë gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it. Më vonë plani ndryshoi në dy gjyqtarë ndërkombëtar, dy gjyqtarë serb të Kosovës, dy gjyqtarë shqiptarë të Kosovës dhe një numër të ngjashëm të prokurorëve. Se kur kjo përbërje e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të fillojë punën mbetet e pacaktuar në kohën e përpilimit të këtij raporti.

¹² Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2010/5, ja janar 2010, faqe 13. Veç kësaj në Komunikatën e vet për Shtyp të 14 tetorit 2009, EULEX-i jep një numër të përafërt prej më shumë se 3,000 shkresave të lëndëve që janë gjetur, organizuar, regjistruar dhe klasifikuar.

¹³ Informacion i marë përmes intervistave të zhvilluara me anëtarë nga ekipi i evidentimit në fund të tetorit 2010.

Shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut

Mungesa e sistemit gjyqësor plotësisht funksional në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica çon në shkelje serioze të të drejtave të njeriut, në veçanti në shkelje të së:

- drejtës për qasje në drejtësi;
- drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme;
- të drejtës për liri.

E drejta për qasje në drejtësi

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) parasheh se “[ç]dokush [ka] të drejtën që ta ketë çfarëdo parashtrere që ndërlidhet me të drejtat dhe obligimet e tij civile të dorëzuar pranë gjykatës ose tribunalit,”¹⁴ dhe se “pengesa, qoftë edhe e karakterit të përkohshëm, mund të bie në kundërshtim me Konventën [Evropiane] [për të Drejtat e Njeriut].”¹⁵ GjEDNJ ka përcaktuar të drejtën për qasje në gjykatë si veti elementare të konceptit më të përgjithshëm mbi “sundimin e ligjit”, që është pjesë e “[...] trashëgimisë zakonore” të shteteve të Këshillit të Evropës¹⁶ dhe ka komentuar se “[...]njeriu vështirë që mund të përfitoj nga sundimi i ligjit pa ju dhënë mundësia e të pasurit qasje në drejtësi.”¹⁷

Që nga 20 shkurti 2008, banorëve të Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq u është penguar vazhdimisht e drejta për qasje në drejtësi. Vetëm në raste që janë konsideruar urgjente, individët nga këto komuna kanë mundur të kërkojnë drejtësi pranë gjykatave të rivendosura që janë duke funksionuar me kapacitet të kufizuar. EULEX-i ka trajtuar vetëm një numër simbolik të lëndëve penale, përderisa shumica dërmuese e procedurave si në gjykimet penale ashtu edhe në paditë civile vazhdojnë të mbeten të suspenduara për kohë të pacaktuar. Në shumicën dërmuese të rasteve, mungesa e gjykatës së qarkut plotësisht funksionale ende ndalon procedimin e ankesave të ngritura kundër vendimeve të gjykatave komunale në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica.

Një tjetër problem serioz që del nga mungesa e një sistemi plotësisht funksional gjyqësor në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica, është skadimi i mundshëm të parashkrimit ligjor për shumë raste penale dhe kundërvajtje që kanë ndodhur në Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq.¹⁸ Siç u përmend më herët në këtë raport, shumica dërmuese e veprave penale dhe kundërvajtjeve përfshijnë vepra që pohohet të jenë kryer në territorin e këtyre komunave klasifikohen si jo-urgjente. Këto raste nuk po trajtohen, dhe si të tilla ka rrezik që periudha e parashkrimit ligjor do të skadojë, para se ato të kompletohen.¹⁹ Ky rrezik është veçanërisht i lartë për kundërvajtjet, për të cilat ligji parasheh një periudhë mjaft të shkurtër të parashkrimit ligjor.²⁰

¹⁴ GjEDNJ, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi 4451/70, 21 shkurt 1975, paragrafi 36.

¹⁵ *Ibid*, paragrafi 26.

¹⁶ *Ibid*, paragrafi 34.

¹⁷ *Ibid*, paragrafi 34.

¹⁸ Ky kërcënim lidhur me skadimin e mundshëm të periudhës së parashkrimit ligjor para se rastet të trajtohen në mënyrë efektive qëndron edhe për rastet shkresat e lëndëve të të cilave janë të bllokuara në objektin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica, në mënyrë të veçantë rastet që përfshijnë kundërvajtje dhe vepra penale që bien nën juridiksionin e gjykatës komunale, për të cilat ligji parasheh periudhë të shkurtër të parashkrimit ligjor. Shih nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 23/79) dhe nenin 90 paragrafi 1 pika 6 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

¹⁹ Mos-funksionimi i plotë i gjykatave dhe shërbimeve të prokurorisë në komunat veriore mund megjithatë të justifikojë ndërprerjen e periudhës së parashkrimit ligjor për ndjekje penale, sipas Nenit 91 (2) KPPK.

²⁰ Shih nenin 27 paragrafi 1 nga Ligji mbi Kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr. 23/79).

Pamundësia për t'i zgjidhur siç duhet këto vepra penale dhe kundërvajtjeve, vazhdon të pengojë të drejtën e viktimës për të kërkuar drejtësi. Kjo ka implikime për të drejtat e viktimës, ka një efekt serioz mbi sundimin e ligjit në rajon dhe dëmton rëndë besimin e publikut në zbatimin e ligjit dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë.²¹

E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme

GjEDNJ ka gjetur se e drejta e një individi për gjykim brenda kohës së arsyeshme gjeneron një detyrim reciprokisht pozitiv mbi autoritetet që të organizojnë sistemin e tyre ligjor në një mënyrë të tillë që të ua mundësojë gjykatave të përmbushin kushtin e “kohës të arsyeshme.”²² Më tej nënvizon se “[...] trazira publike në rajonin ku mbahet një gjykim mund të justifikojë vonesat në procedurë vetëm për aq kohë sa autoritetet publike të ndërmarrin hapa për transferimin e rasteve të një tjetër juridiksion.”²³ Në përgjithësi, sa herë që autoritetet publike ballafaqohen me një zbrapsje të përkohshme të punës, ata duhet të ndërmarrin me shpejtësinë e duhur, veprime korrigjuese për të trajtuar një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji.²⁴

Të ballafaquar me ndërprerje në funksionimin e gjykatave në Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë vetëm masa të kufizuara për të trajtuar situatën. Aktualisht të rivendosura, gjykata e qarkut, komunale dhe ajo për kundërvajtje e Mitrovicë/Mitrovica trajtojnë vetëm rastet urgjente dhe ato me prioritet penale civile dhe kundërvajtjet. Shumë prej atyre rasteve nuk janë përfunduar, por janë lënë pezull në ndonjë fazë procedurale, siç është përkohërisht më lartë.

Rastet penale urgjente nga gjykatat komunale jo-funksionale në Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq kanë filluar të transferohen në gjykatat me juridiksion të shkallës së njëjtë, për herë të parë një vit pasi që ato gjykata ndaluan funksionimin. Procedimi i rasteve të tilla urgjente penale, civile dhe të kundërvajtjeve qoftë në gjykatat e rivendosura apo përmes transferimit të juridiksionit, është një zhvillim pozitiv në vetvete. Megjithatë, shumica e rasteve pranë gjykatave të Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq ende janë të vonuara ose të pezulluara për kohë të pacaktuar.

EULEX-i, brenda mandatit të vet²⁵ dhe me nivelin e tanishëm të personelit, ndihmon në procedimin e rasteve më të rënda, por kjo nuk mund të kompensojë mungesën e një gjyqësori plotësisht funksional në rajon. Si rrjedhojë, vonesat e paarsyeshme në procedimin e shumicës

²¹ Një nga pasojat e pamundësisë së drejtësisë për të ushtruar juridiksionin e vet është perceptimi në ngritje i mos-ndëshkimit, veçanërisht në mesin e të rinjve.

²² Shih për shembull, GjEDNJ, *Spentzouris kundër Greqisë*, 47891/99, Aktgjykimi i 7 majit 2002, paragrafi 27. Shih gjithashtu *Eckle kundër Gjermanisë*, 8130/78, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 92. Në një tjetër rast Gjykata vlerësoi se “një zbrapsje e përkohshme e punës nuk ka të bëjë me detyrim e [...] [Institucioneve], me kusht që ata të ndërmarrin, me shpejtësinë e duhur, veprimet korrigjuese për të trajtuar një situatë të jashtëzakonshme” (GjEDNJ, *Milasi kundër Italisë*, 10527/83, Aktgjykimi i 25 qershorit 1987, paragrafi 18).

²³ Shih GjEDNJ, *Foti kundër Italisë*, 7604/76, 7719/76, 7781/77 dhe 7913/77, Aktgjykimi i 10 dhjetorit 1982, paragrafi 61.

²⁴ Shih GjEDNJ, *Baggetta kundër Italisë*, 10256/83, Aktgjykimi i 25 qershorit 1987, paragrafi 23.

²⁵ Shih nenin 3. Veprim i Përbashkët i Këshillit të Evropës 2008/124/ CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË. Pjesërisht, EULEX-i është i mandatuar që të “mësoj, monitoroj dhe të këshillojë institucionet e Kosovës në të gjitha sferat që ndërlidhen me sundim më të përhapur të ligjit (përhirë edhe shërbimin e doganave) përdërisa mban edhe disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive.” Këto përgjegjësi përfshijnë, *inter alia*, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e disa rasteve.

së rasteve pranë gjykatave në Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq ka gjasa të vazhdojnë të jenë normë e jo përjashtim. Veçanërisht shqetësuese është gjendja në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, e cila nga natyra e juridiksionit të vet duhet të trajtojë rastet ku përfshihen veprat më të rënda penale. Deri nga fundi i tetorit 2010, ka pasur më shumë se 200 aktakuza në pritje të konfirmimit para gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica dhe nuk është ende e qartë se kur do të konfirmohen këto aktakuza dhe rastet të referohen për shqyrtim kryesor.

Me 26 maj 2008 një prokuror i qarkut i Mitrovicë/Mitrovica kishte ngritur një aktakuzë kundër një oficeri të policisë, shqiptar i Kosovës që akuzohej për vrasje të rëndë në tentativë;²⁶ pronësi, kontroll, posedim, apo përdorimin të paautorizuar të armëve;²⁷ marrje ryshfeti;²⁸ shpërdorimi të pozitës ose autoritetit zyrtar;²⁹ mashtrim;³⁰ dhe dy akuza të keqtrajtimit në ushtrimin e detyrave.³¹ Gati dy vjet e gjysmë kanë kaluar dhe ende nuk është caktuar seancë për konfirmim në këtë rast, pavarësisht nga fakti se ligji kërkon nga gjykatat që të caktojnë seancën për konfirmim të aktakuzës, menjëherë dhe jo më vonë se dy muaj nga data kur është ngritur aktakuza.³²

OSBE-ja gjithashtu ishte duke monitoruar një numër të rasteve civile, duke përfshirë rastet pronësore ndëretnike, kur funksionimi i gjykatave në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica u ndërpre në shkurt të vitit 2008. Në atë kohë veçse ka pasur vonesa të konsiderueshme në procedimin e këtyre rasteve; disa prej tyre datojnë që nga viti 2001. Sipas informatave në dispozicion të OSBE-së, këto raste mbeten të bllokuara dhe po presin që gjykatat në veri të Kosovës të rifillojnë funksionimin e duhur.

E drejta për liri

Si praktika gjyqësore e GjEDNJ-së, ashtu dhe korniza ligjore e Kosovës parashohin rishikimi periodik të paraburgimit nga gjykata.³³ Në rast të paraburgimit të zgjatur, “autoritetet kompetente nacionale” kanë për detyrë të tregojnë se arsyet për paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë, dhe të tregojnë “përkushtim të veçantë gjatë zhvillimit të procedurës.”³⁴ Paraburgimi nuk duhet të zgjasë më shumë se që është e nevojshme,³⁵ përndryshe bëhet i paligjshëm. Personi i paraburgosur ka të drejtën “për gjykim brenda kohës së arsyeshme ose të lirohet në pritje të gjykimit.”³⁶

Mungesa e një sistemi gjyqësor dhe prokurorial plotësisht funksional në komunat veriore çon në shkelje serioze të së drejtës për liri. Nga fundi i tetorit 2010, lista e të paraburgosurve pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, tregonte se 39 persona po mbaheshin në paraburgim dhe 18 persona tjerë në arrest shtëpiak. Një listë e ngjashme nga gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica, tregonte dy persona në paraburgim. Urdhrat për paraburgim

²⁶ Neni 147 KPK.

²⁷ Neni 328(2) KPK.

²⁸ Neni 343 KPK.

²⁹ Neni 339 KPK.

³⁰ Neni 261 KPK.

³¹ Neni 164 KPK.

³² Nenet 309(1) dhe 312(2), KPPK.

³³ Nenet 212(4) dhe 284-287 KPPK.

³⁴ Neni 285 (1) KPPK; shih gjithashtu *Dobrev kundër Bullgarisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 10 gushtit 2006, paragrafi 79.

³⁵ Neni 5(3) KPPK; shih gjithashtu *Labita kundër Italisë*, GjEDNJ aktgjykimi i 6 prillit 2000, paragrafi 152.

³⁶ Neni 5 (3), KEDNJ.

kundër shumë prej këtyre të pandehurve u shtynë vazhdimisht gjatë periudhës që kur gjykatat funksiononë vetëm me kapacitet të kufizuar.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur i akuzuar për vrasje³⁷ dhe për pronësi, kontroll, posedim, apo përdorimi të paautorizuar të³⁸ është mbajtur në paraburgim që prej 1 tetorit 2007.

Në një rast tjetër pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur i akuzuar për vrasje³⁹ është mbajtur në paraburgim që prej 5 nëntorit 2007. Rasti i tij nuk i është transferuar gjyqtarëve të EULEX-it.

Shumë persona tjerë të paraburgosur, në bazë të urdhrave të lëshuara nga gjykata e qarkut apo ndonjë gjykatë komunale në Mitrovicë/Mitrovica, ndodhen në situatë të ngjashme. Kjo gjendje ngrit shqetësime serioze sa i përket respektimit të së drejtës së tyre fundamentale për liri.

Vështirësitë operative për gjyqtarët dhe prokurorët që aktualisht janë përkohësisht të rivendosur

Një raport mbi sistemin e drejtësisë lidhur me rajonin e Mitrovicë/Mitrovica nuk do të ishte i plotë përmendur kushtet shumë të vështira të punës në të cilat aktualisht veprojnë gjyqtarët, prokurorët dhe personeli ndihmës nga gjykatat dhe prokuroritë e rivendosura.

Siç u përmend më herët në këtë raport, në gjykatën komunale në Vushtrri/Vuçitrn përveç stafit të saj, aktualisht është i vendosur edhe personeli i gjykatës së qarkut, komunale dhe për kundërvajtje nga Mitrovicë/Mitrovica si dhe personeli i prokurorisë publike të qarkut dhe asaj komunale të Mitrovicë/Mitrovica. Lokalet e gjykatës komunale të Vushtrri/Vuçitrn janë kështu rëndë të mbingarkuara dhe të gjithë zyrtarët që punojnë aktualisht në këtë gjykatë, si dhe të gjitha palët që vijnë para tyre, duhet të veprojnë në një mjedis shumë të dyndur.⁴⁰ Në këtë kontekst, duhet të përmendet se situata nuk është përmirësuar në mënyrë evidente që nga koha kur OSBE për herë të fundit ka raportuar lidhur me situatën e sundimit të ligjit në rajon.

Kushte të tilla pune bien shumë prapa standardeve të themeluara ndërkombëtare,⁴¹ dhe dëmtojnë jo vetëm punën dhe efikasitetin e gjykatave, por edhe vet dinjitetin që duhet të jetë thelbësor në funksionimin e organeve gjyqësore. Duke u dashur të veprojnë në një mjedis të tillë e bën pothuajse të pamundur për gjykatësit dhe prokurorët që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive, dhe gjithashtu çojnë në një mori problemesh dhe vështirësive të përditshme logjistike. Ajo që është dhënë më-poshtë mund të shërbejë si shembull.

Që prej majit të vitit 2010, prokuroria publike e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica ka filluar të pranojë vetëm raste ku parashihet zbatimi i ndonjë prej masave të dhëna në

³⁷ Neni 146, KPK.

³⁸ Neni 328(2), KPK.

³⁹ Neni 30(1), Ligji Penal i Krahinës Socialiste të Kosovës. Informata është marë nga regjistri në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë/Mitrovica, tetor 2010.

⁴⁰ Raporti i OSBE-së, *Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë/Mitrovica: risitë lidhur me status dhe shqetësimet e vazhdueshme për të drejta të njeriut*, (shkurt 2010). http://intranet/n/s/documents/monitoring/6/10022243_1455_sq.pdf.

⁴¹ Shih Parimin V (2), Rekomandimi Nr. R (94) 12, të Këshillit të Ministrave nga Shtetet Anëtare mbi Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve, e adoptuar nga Këshilli i Ministrave, me 13 tetor 1994 në takimin e 518-të të Zëvendës Ministrave.

Kapitullin XXX të Kodit të Procedurës Penale i Kosovës (KPPK),⁴² rastet e parashtruara nga Agjencia e Kosovës Anti-Korrupsion, rastet që përfshijnë shtetas të huaj në cilësi të të dyshuarve apo palëve të dëmtuara dhe rastet kur persona zyrtar (veçanërisht zyrtarë të policisë) janë palë të dëmtuara.

Të gjitha lëndët tjera nuk pranohen për shkak të mungesës së hapësirës së nevojshme për ruajtjen e tyre.

Përfundim

Ka pasur disa zhvillime inkurajuese në funksionimin e sistemit gjyqësor në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica që nga koha e raportit të fundit të OSBE-së në shkurt të vitit 2010 deri më tani. Megjithatë, pjesa më e madhe e gjyqësisë së rajonit mbetet e paralizuar.

Gjykatat dhe prokuroritë aktualisht të rivendosura nuk mund të trajtojnë në mënyrë efektive rastet dhe paditë e ngritura pranë tyre, duke i lënë banorët e rajonit të Mitrovicë/Mitrovica me qasje shumë të kufizuar në drejtësi. Shumica e rasteve penale, civile dhe të kundërvajtjeve vazhdojnë të mos trajtohen duke rrezikuar që periudha e paraparë për parashkrim ligjor të tyre të skadojë. Kur rastet procedohen, shpesh ndodhin vonesa të paarsyeshme dhe pezullime për kohë të pacaktuar. Shumë të pandehurve të mbajtur në paraburgim vazhdimisht u shtyhet paraburgimi dhe gjykatat e prokuroritë e rivendosura qartazi vazhdojnë të mos jenë në gjendje të trajtojnë me zell të veçantë rastet e paraburgimit, që kërkohet prej tyre me ligj vendor dhe ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh kapacitetet aktuale në personel, juridiksion të kufizuar dhe pengesat me hapësira, ndikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, edhe pse inkurajues, ende është modest. EULEX-i ka përfunduar 23 raste penale në gjykatën e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica për më shumë se dy vite që nga vendosja e tyre deri me sot.

Mungesa e një sistemi gjyqësor plotësisht funksional në veri të Kosovës ka pasoja të mëdha serioze në të drejtën e individit për qasje në drejtësi, gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe në liri. Kjo ka zgjatur tashmë për gati tre vite dhe në masë të madhe ka zbehur besimin e publikut në institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore, dhe në sundimin e ligjit në përgjithësi. Për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe për t'i vënë fund shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, të gjithë akterët e përfshirë duhet që të rrisin përpjekjet e tyre në mënyrë që të rikthehet një sistem gjyqësor funksional në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica, sa më parë që të jetë e mundur.

⁴² Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 27 nëntor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr 2003/26, që la ligjin përmbajtësisht të njëjtë me ligjin e vitit 2003, edhe pse ishte shtuar një pjesë për aranzhimet lidhur me deklarimin e fajësisë, një nen mbi kohëzgjatjen e paraburgimit policor ishte ndryshuar dhe emri i ligjit ishte ndryshuar në Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.